VENDIM
Nr. 1033, datë 16.12.2020

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 469, DATË 26.7.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 8, shtohet pika 8/1, me këtë përmbajtje:

"8/1. Pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën funksionon Këshilli Koordinues i Arsimtarëve të Diasporës, i cili ka për qëllim të japë informacionet e nevojshme të lidhura me çështjet e arsimit, si dhe propozime konkrete të lidhura me to.".

b) Pas pikës 13, shtohen pikat 13/1, 13/2, 13/3, 13/4, 13/5, 13/6 e 13/7, me këtë përmbajtje:

"13/1. Këshilli Koordinues i Arsimtarëve të Diasporës është organ kolegjial i përbërë nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët zgjidhen nga radhët e arsimtarëve me origjinë shqiptare në diasporë dhe ushtrojnë mësimdhënien për komunitetet shqiptare në diasporë.

13/2. Anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimtarëve të Diasporës propozohen nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën dhe miratohen nga ministri përgjegjës për diasporën. Anëtarët e këtij këshilli janë vullnetarë, të cilët duhet të jenë me origjinë shqiptare, si dhe të kenë së paku 5 (pesë) vjet eksperiencë në mësimdhënie.

13/3. Funksionimi i Këshillit Koordinues të Arsimtarëve të Diasporës realizohet sipas rregullave të parashikuara në rregulloren përkatëse të tij, e cila miratohet nga Këshilli.

13/4. Këshilli Koordinues i Arsimtarëve të Diasporës, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për politikën e jashtme dhe Qendrën e Botimeve për Diasporën, organizon takimin vjetor të arsimtarëve në diasporë. Shpenzimet financiare të këtij takimi përballohen nga buxheti i Qendrës së Botimeve për Diasporën.

13/5. Këshilli Koordinues i Arsimtarëve të Diasporës bëhet pjesë e konsultimeve dypalëshe, me dakordësim paraprak, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, në funksion të marrëveshjeve për mësimdhënien në diasporë.

13/6. Shpenzimet financiare të aktiviteteve të Këshillit Koordinues të Arsimtarëve të Diasporës përballohen nga buxheti i Qendrës së Botimeve për Diasporën.

13/7. Këshilli Koordinues i Arsimtarëve të Diasporës ka një figurë identifikuese, sipas modelit në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

Ngarkohen Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Shtojca nr.1

3